



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.103/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Nenad Lazic, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit V. L. nga P., rruga "... " të cilin e përfaqëson avokat Qendresa Lajçi, kundër të paditurës P.C. B., Bulevardi "...", P., të cilën e përfaqëson avokat Kujtim Kërveshi nga P., për shkak të kompensimit të ardhurave personale, duke vendosur sipas revizionit i paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.504/2019 datë 13.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30.03.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pathemeltë revizioni i paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.504/2019 datë 13.10.2021.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.15.07.2018, të datës 22.02.2018 aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit V. L., nga P., nr..., detyrohet e paditura, që paditësit t'ia kompensoi në emër të ardhurave personale, për periudhën 01.09.2012 e deri me 30.09.2016, shumën prej 41,678.00€ paga neto, përfshirë edhe kontributin pensional në shumë prej 2,319.00 €, tatimin në burim në shumë prej 1,191.94€, e që paraqet dyfishin e shumës prej 20,839.00€ të gjitha këto me kamatën vjetore ligjore siç e paguajnë bankat për mjetet pa destinacion të caktuar, të afatizuara për 12 muaj duke filluar nga data 22.10.2018 e deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 3,428.12€, e të gjitha kërkesat në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarimit ligjor.

Në pikën II të dispozitivit refuzohet pjesa e kërkesëpadisë me të cilën ka kërkuar që të aprovohet padia e paditësit ndaj të paditurës në tërësi si e bazuar dhe të anulohen si të kundërligjshme neni 4 i kontratës së punës, nr ..., i datës 29.06.2016 e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës, me të cilin paditësi është kthyer në vendin e punës si Analist Kredie dhe neni 8 i kësaj kontrate me të cilin paditësit i është caktuar paga mujore në shumë prej 600.00 € nga data 03.10.2016 e tutje, që të detyrohet e paditura, paditësit t'ia paguaj dëmin për shkak të pushimit të kundërligjshëm nga puna, në bazë të nenit 80 par 1 nënpar. 1.2 i Ligjit për Punën si vijojnë: a) Në emër të ardhurave personale të perealizuara nga data 01.09.2009 deri më 31.08.2012 në neto, shumën prej 18,724.69€; b) Në emër të kontributeve të paguara në sigurimin pensional për periudhën nga data 01.09.2009 deri më 31.08.2012 shumën prej 2,070.00€; c) Në emër të tatimit në të AP për këtë periudhë nga data 01.09.2009 deri më 31.08.2012, e cila duhet të paguhet në ATK, shumën prej 1,339.75 €; që të detyrohet e paditura si në pikën II, nën a, b, c të këtij petitumi, ti paguaj kamatën si për mjetet e afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar, duke u llogaritur nga data 01.09.2012 e deri në pagesën definitive; Që të detyrohet e paditura që paditësit: a) Në emër të pagave të papaguara, dhe diferencës së pagave për të ardhurat personale të perealizuara, për periudhën nga data 01.09.2012 deri më 30.06.2017, së bashku me kamatën ligjore, paditësit ti paguaj shumën prej 54,340.00 €; b) Në emër të diferencës në të ardhurat personale të papaguara (nga 1,326.93 €-600€) nga data 01.07.2017, deri më 22.10.2018, t'ia paguaj veç e veç nga 615 €; c) Në emër të mosshfrytëzimit të pushimit vjetor për vitin 2011-2016 së bashku me kamatë ligjore për këtë periudhë paditësit ti paguaj shumën prej 4,412.52 €; d) Në emër të kontributit pensional, për periudhën prej 01.09.2012 deri më datë 30.06.2017, i cili duhet të transferohet në Trustin e Kursimeve Pensionale të paditësit , së bashku me kamatën ligjore për këtë periudhë, shumën prej 6,028.00 €; e) Në emër të tatimit në këto paga, së bashku me kamatën ligjore për periudhën, 01.09.2012 deri më 30.06.2017, e cila shumë duhet të transferohet nga llogaria e ATK-së në shumë prej 4,439.00€; f) Në emër të tatimit në AP të perealizuara për periudhën 01.07.2017 e tutje deri në pagesën definitive në llogarinë e ATK-së, të paguaj për çdo muaj veç e veç nga 43.67 €; g) Në emër të kontributeve pensionale për periudhën 01.07.2017 e tutje deri në pagesën definitive të paguaj çdo muaj veç e veç shumën prej 69.33€. Që të detyrohet e paditura që borxhin si në pikën IV-nën a,c,d,e,f dhe g te këtij petitumi, ti paguaj si për mjetet e afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar, duke i llogaritur që nga data 01.07.2017 deri në pagesën definitive, ndërsa borxhin si në pikën IV-nën b, ta paguaj me kamatë prej 8%, për çdo muaj veç e veç, duke e llogaritur nga data 01.07.2017, e tutje deri në pagesën definitive; Që të detyrohet e paditura që në bazë të nenit 144.2 të LPK-së, paditësit , në emër të ardhurave personale mujore për të ardhmen ti paguaj për çdo muaj 1,326.93€, me kamatë prej 8%, duke u llogaritur nga data 01.11.2018 , deri në pagesën definitive si kërkesë e pabazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.504/2019 datë 13.10.2021, në pikën I të dispozitivit refuzohet si e pa themeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit V. L. nga P., rr."..." ..., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1507/16, i datës 22.10.2018, në pikën I të dispozitivit në pjesën që ka të bëjë me kamatën dhe shpenzimet e procedurës si dhe me pjesën refuzuese, vërtetohet. Në pikën II të dispozitivit aprovet e themeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës P.C.B., Bulevardi "...", P., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1507/16, i datës 22.10.2018 në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit në pjesën e kompensimit të ardhurave personale, kontributit pensional si dhe tatimit në burim ashtu që tani gjykohet si vijon: detyrohet e paditura P.C. B., Bulevardi "...", Prishtinë, që paditësit t'ia kompensoj në emër të ardhurave personale, për periudhën prej 01.09.2012 e deri me 30.09.2016, shumën prej 20,839.00 €, ku prej tyre për kontributin pensional t'i paguajë shumën prej 2,319.00€, ndërsa për tatim në burim t'i paguajë shumën prej 1,191.94€.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor e autorizuar e paditësit, avokat Q. L. nga P., ka paraqitur revizion, për shkak shkeljes së standardeve ndërkombëtare, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, siç thuhet në revizion aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoi në pjesën refuzuese dhe të aprovoi kërkesëpadinë e paditësit si në precizimin e datës 25.03.2018 dhe t'ia kompensoi edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 6,613.70€ ose aktgjykimin e shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë ti prish dhe çështjen ta kthej në rigjykim .

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Revizioni i të autorizuarës së paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi ka ushtruar padi në gjykatën kompetente, më datë 26.01.2011, e precizuar me parashtresën e datës 21.03.2018, pranë gjykatës së shkallës së parë, me arsye si në padi. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, C.nr.2569/11, i datës 14.12.2012 ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit dhe anulohet si i kundërligjshëm njoftimi i të paditurës i datës 15.12.2010, për përmbylljen e kontratës së punës, të detyrohet e paditura që paditësin ta kthej në punë në vendin e mëparshëm të punës-Zyrtar Kreditor- Dega e "P. C. B." në P. Detyrohet e paditura "P. C. B." në P., që paditësit V. L., në emër të ardhurave personale mujore të perealizuara për periudhën kohore prej dt. 01.09.2009 deri me dt. 31.08.2012 duke i llogaritur edhe kamatën sipas

arritjeve mujore për pagesë, t'ia paguaj shumën prej 18.724,69 Euro, në emër të kontributit të papaguar për sigurimin pensional dhe invalidor në llogari të Trustit Pensional shumën prej 2.070 Euro, si dhe që nga dt. 01.09.2012 e derisa paditësi të kthehet në vendin e punës tek e paditura t'ia paguaj për çdo muaj nga 850 Euro në emër të ardhurave personale mujore, e këtë me kamatë prej 3.5 % për çdo muaj. IV. Detyrohet e paditura që kthimin e paditësit në vendin e punës sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pagesat e shumave sipas pikës III të dispozitivit si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës në shumë prej 779,72 Euro, t'i bëjë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, me kërcënim të përmbarrim forcërisht..

Gjykata e Apelit me aktgjykimin, Ac.nr.1955/13, i datës 27.06.2016 e ka aprovuar pjesërisht ankesën e të paditurës duke e kthyer në rigjykim pikën III dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit në pjesën e lartësisë së kërkesëpadisë. Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor lidhur me pjesën e kthyer në rigjykim, me aktgjykimin, C.nr.1507/16, i datës 22.10.2018 e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se për ta përcaktuar në mënyrë të saktë vlerën e të ardhurave për periudhën kontestuese, me propozimin e të autorizuarit të paditësit ka caktuar ekspertin financiar A. B., i cili në ekspertizën e plotësuar të datës 01.01.2018 të cilës ekspertizë gjykata edhe ia ka falur besimin ka konstatuar se po të punonte paditësi në periudhën prej momentit të largimit nga puna 01.09.2012 e deri me 30.09.2016, do të realizonte shumën prej 20,839.00€,paga, përfshirë edhe kontributin pensional në shumë prej 2,319.00€, tatimi në burim në shumë prej 1,191.94 €.

Mirëpo, pasi që i autorizuari i paditësit kishte propozuar që ekspertiza të plotësohet me arsyetimin se duke u bazuar në faktin që të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet kanë pësuar ngritje të vazhdueshme të pagave, gjykata me aktvendim ka aprovuar këtë propozim dhe ka detyruar të paditurën që llogaritja e pagave të bëhet me ngritjet eventuale të pagave për të njëjtin vend pune dhe atë gjykata duke iu referuar pretendimeve të palëve ndërgjyqëse lidhur me vëllimin e kërkesës ka lejuar kryerjen e disa ekspertizave si ajo e datës 14.07.2017, ekspertiza e datës 12.03.2018, ekspertiza e datës 10.05.2018, ekspertiza e datës 01.10.2018, dhe duke pasur për bazë edhe kërkesën e paditësit dhe të paditurës ka vendosur edhe për lartësinë e kërkesës. Gjykata ka vendosur t'ia kompensoj dyfishin e pagave, pasi që ishte vërtetuar se paditësit në mënyrë të kundërligjshme i është marrëdhënia e punës andaj duke iu referuar neni 80 par.1 të Ligjit të Punës ka vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit. anë të pa themelta.

Gjykata e Apelit ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vepruar kur e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke e aprovuar dyfishin e shumës së konstatuar me ekspertizën e parë, sepse e paditura ka qenë e detyruar të paguajë vetëm kompensimin e pagave gjatë kohës kur paditësit kundërligjshëm i është ndërprerë marrëdhënia e punës, dhe se me kontratën e re paga i është caktuar 600.00 euro, andaj e paditura nuk ka obligim që të paguajë më tepër se ajo shumë, e kjo gjen mbështetje edhe në nenin 55 të Ligjit të Punës i cili përcakton se: "I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit" ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton se: "Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e Punës".

Në rrethana faktike të përshkruara më lartë, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se është i pranueshëm qëndrimi juridik i gjykatës shkallës së dytë, kur nga arsyet e sipër theksuara, ka vendosur për aprovimin e ankesës së paditësit, përkatësisht, ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë duke e aprovuar shumën prej 20,839.00€ dhe duke e refuzuar pjesën tjetër, dyfishin e kësaj shume. Kjo gjykatë vlerësoi se aktgjykimi i atakuar me revizion nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat gjykata e revizionit, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave me të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, arsyet për mënyrën e vërtetimit të fakteve, provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të tyre. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm.

Në këtë kontekst me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjyqimeve të instancave më të ulëta. Në kuptim të nenit 160.4 të LPK arsyetimi i aktgjyqimit duhet të përmbajë kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar si dhe vlerësimin e atyre kërkesave, fakteve dhe provave të parashtruara nga palët në procedurë. Nga arsyetimi i këtij aktgjyqimi po rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kuptim të kësaj dispozite ligjore.

Lidhur me pretendimin e revizionit për cenim të Konventës Evropiane mbi të drejtat e njeriut, për shkak të zvarritjes së procesit, Gjykata Supreme konstaton se zvarritja e procesit- stërzgjatja është fakt notor në rastin konkret, por nuk i jep mundësi kësaj gjykate për vendimmarrje tjetër. Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut ka marr si praktikë të mirë qëndrimin se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në frymën e rrethanave të posaçme të rastit dhe duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në praktikën gjyqësore të gjykatës, në veçanti kompleksitetin e rastit, ... dhe rëndësinë e objektit të trajtuar në procedurë". Prandaj është e pamundur për gjykatën Supreme që të ndryshoi rrethanat e zgjatjes së procedurës në rastin konkret, gjë që edhe në revizion nuk kërkohet ndo një veprim i kësaj gjykate mbi bazën e zgjatjes së procesit.

Lidhur me pretendimin e diskriminimit në kuptim të nenit 5 të Ligjit të Punës, kjo gjykatë konsideron se në rastin konkret nuk është konsumuar diskriminimi i përshkruar në nenin 3 të Ligjit Nr. 05/L -021 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi i cili parasheh në paragrafin 1 se ." Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilado nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, se Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuar në nenin një (1) të këtij Ligji që kanë të bëjnë me veçoritë e pretenduesit të diskriminimit. Në rastin konkret me aktgjykimin e formës së prerë C.nr.2569/2011 të datës 14.12.2012, i cili është vërtetuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr.1955/2013, të datës 27.06.2016 është shpallur i paligjshëm vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe është obliguar e paditura që paditësin ta kthej në punë.

Pra objekt shqyrtimi në rastin konkret është vetëm lartësia e kompensimit të dëmit në emër të fitimit të humbur, gjë që Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë. Gjykata ka gjetur se largimi nga puna i paditësit ka qenë i kundërligjshëm, dhe për këtë arsye të njëjtin e ka rikthyer në vendim e tij të punës, andaj me këtë rast paditësit i takon vetëm kompensimi i të gjitha pagave dhe përfitimeve të tjera të humbura gjatë largimit të tij nga puna, por jo edhe dyfishi i

tyre, sepse gjatë kësaj kohe ai nuk ka qenë në punë e as që ka kryer punë për të paditurën, andaj edhe pretendimet e revizionit lidhur me këtë u refuzuan si të pa bazuara.

Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson se është zbatuar drejtë dispozita e nenit 55 par 2 i Ligjit të Punës që parasheh se " Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.

Nga arsyet e sipër përmendura dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.103/2022,datë 30.03.2022

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami